



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
KORÇË

Nr. 107 Prot.

Korçë, më 27.08.2025

URDHËR Nr. 21

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2025-2027

Në mbështetje të VKM nr. 515, datë 19.07.2006, i ndryshuar "Për Ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", të VKM nr.859, datë 26.12.2024 " Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2024-2030"

URDHËROJ

1. Miratimin e planit të integritetit për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë, 2025-2027.
2. Ngarkohet stafi i institucionit të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë, për njohjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

TITULLARI I KOMANDUAR
Emiljano Muharem





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE
BUJQËSORE KORÇË

PLAN INTEGRITETI 2025-2027

Miratur me Urdhrin e Brendshëm Nr.20 , datë 27.05.2025 të Titullarit të Institucionit

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT:

Ky plan u realizua nga Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit, ngritur me Urdhrin nr.20 , date 27.05.2025 të Titullarit të Institucionit, si vijon:

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të objektivit specifik "Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë, me afat zbatimi, të Planit të Veprimit 2025-2027 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratur me VKM nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

TABELA E PËRMBAJTJES:

- **DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL**
- **LISTA E SHKURTESAVE**
- **HYRJE**
- **PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**
- **QASJA METODOLOGJIKE**
- **OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027**
- **RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT**
- **MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**
- **PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027**

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

QTTB Korçë shpreh angazhimin maksimal në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e etikës institucionale. Nëpërmjet këtij plani synojmë të forcojmë transparencën, besimin publik, përgjegjshmërinë dhe zbatimin me cilësi të shërbimeve për fermerët e qarkut. Integriteti institucional është bazuar në standarde të larta morale dhe profesionale që fillojnë nga drejtuesit dhe përçohen te çdo punonjës i institucionit.

Qëllimi i QTTB është transferimi i teknologjive bujqësore, identifikimi, testimi dhe futja në praktikat bujqësore të metodave dhe materialeve të reja për vendin.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të QTTB Korçë dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Kërkimi, përshtatja dhe promovimi i teknologjive bashkëkohore në bujqësi, blegtori dhe hortikulturë në përputhje me kushtet agro klimatike të rajonit të Korçës. Nxitja e praktikave bujqësore që ruajnë tokën, ujin dhe biodiversitetin si dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Trajnimi, këshillimi dhe transferimi i njohurive te fermerët, shoqatat bujqësore dhe grupet e interesit për zbatimin e praktikave të mira bujqësore dhe teknologjive inovative.

LISTA E SHKURTESAVE:

- ❖ **MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**
- ❖ **MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit**
- ❖ **QTTB – Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë**
- ❖ **NJQP—Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme**

HYRJE

Plani i Integritetit 2025–2027 për QTTB Korçë bazohet në përvojën e vitit 2024 dhe synon të përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ai hartohet në përputhje me MVRI dhe planin kombëtar kundër korrupsionit.

Plani i Integritetit 2024, i miratuar synon përmirësime dhe përditësime në fushat dhe drejtimet e veprimtarisë së QTTB Korçë, si:

Objektivi I: Menaxhimi i burime njerëzore (Hartimi i proceseve të punës, Plotësimi i vendeve vakante dhe Trajnimi i vazhdueshëm i stafit)

Objektivi II: Zhvillimi i Sektorit Bujqësor dhe Blegtoral (rritja e prodhimit/prodhimtarisë së bimëve dhe kafshëve)

Objektivi III: Rritja e transparencës dhe etikës institucionale në ofrimin e shërbimeve.

Objektivi IV: Menaxhimi efektiv i logjistikës dhe infrastrukturës teknike.

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në QTTB Korçë konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1. Ngritjen e grupit të punës me urdhër të titullarit.
2. Identifikimin e risqeve nëpërmjet analizës së dokumenteve, intervistave dhe anketave.
3. Vlerësimin e risqeve dhe propozimin e masave të adresimit.
4. Hartimin e planit të veprimit me masa konkrete.

QASJA METODOLOGJIKE

U përdor qasja cilësore në përputhje me MVRI:

- Intervista me staf dhe drejtues.
- Analizë e dokumenteve zyrtare.
- Auditime të brendshme dhe anketim me fermerët.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027

1. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore.
2. Zhvillimi i sektorit bujqësor dhe blegtoral përmes transferimit të teknologjive.
3. Përmirësimi i infrastrukturës logjistike (makineri, laboratorë).
4. Rritja e transparencës dhe lufta kundër korrupsionit.

Këto objektiva strategjike bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

RISQET DHE FAKTORËT E RISQVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në QTTB Korçë . Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi si në vijim:

- **Burimet njerëzore:** vende vakante, mungesë trajnimi.
- **Infrastrukturë:** mungesë e pajisjeve dhe makinerive.
- **Planifikim:** vonesa në projektet e MBZHR.
- **Laboratori:** mungesë e pajisjeve dhe akreditimit.
- **Prodhimtaria:** mungesë e planeve të strukturuar. Rreziku që lidhet me uljen e eficiencës dhe cilësisë së prodhimit shkencor, demonstrativ dhe teknik të institucionit për shkak të faktorëve të brendshëm ose të jashtëm.

Shkaqet e mundshme: Burime të pamjaftueshme financiare për eksperimentime, pajisje dhe teknologji moderne. Mungesë apo mungesë e përkohshme e specialistëve me ekspertizë të thelluar në fusha të caktuara. Planifikim i dobët i veprimtarive tekniko-shkencore, pa objektiva të matshëm dhe pa ndjekje të performancës. Mungesa e bashkëpunimit aktiv me fermerët, universitetet dhe aktorë të tjerë të sektorit bujqësor. Mungesë motivimi tek stafi për shkak të kushteve të punës, mungesës së stimujve ose mungesës së vlerësimit profesional.

MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Koordinatori i Integritetit do të realizojë raportime gjashtëmujore për zbatimin e masave. Monitorimi do të përfshijë analizën e progresit dhe publikimin e rezultateve në faqen zyrtare.

PLANI I VEPRIMIT 2025–2027

Objektivi 1: Menaxhimi i burimeve njerëzore

Nr.	Aktiviteti	Risku	Masa	Afati	Përgjegjësi
1.1	Hartimi dhe aprovimi i hartave të proceseve të punës për çdo njësi funksionale të QTTB Korçë	Gabime në përmbushjen e detyrave ditore për shkak të mungesës së udhëzimeve të standardizuara	Identifikimi i proceseve kyçe, përshkrimi i hapave, konsultimi me stafin dhe miratimi përfundimtar	Dhjetor 2025	Drejtoria Teknike në bashkëpunim me çdo sektor
1.2	Plotësimi i vendeve vakante përmes bashkëpunimit aktiv me DAP dhe shpalljes transparente të vendeve të lira	Pamundësia për të realizuar të gjitha funksionet për shkak të mungesës së stafit të kualifikuar	Hartimi i një kërkesë zyrtare, ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe përfshirja e stafit të ri në trajnim hyrës	2025–2027	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
1.3	Organizimi i cikleve të trajnimit për stafin mbi etikën, teknologjitë bujqësore dhe zhvillimet ligjore	Njohuri të pamjaftueshme për realizimin cilësor të detyrave	Krijimi i një kalendari vjetor trajnimesh në bashkëpunim me ASPA dhe institucione akademike	Çdo vit	Titullari i institucionit në bashkëpunim me ASPA

Objektivi 2: Zhvillimi i sektorit bujqësor e blegtoral

Nr.	Aktiviteti	Risku	Masa	Afati	Përgjegjësi
2.1	Blerja dhe përdorimi i pajisjeve moderne për rritjen e prodhimit bujqësor dhe menaxhimin më të mirë të fermave demonstrative	Pamundësia për realizimin efektiv të teknologjive për shkak të mungesës së pajisjeve moderne	Hartimi i listës së nevojave logjistike dhe dërgimi i kërkesës pranë MBZHR	2025–2026	QTTB Korçë në koordinim me MBZHR
2.2	Përgatitja dhe shpërndarja e kartave teknologjike për kulturat bujqësore sipas specifikës së zonës	Mungesë udhëzimesh të standardizuara për fermerët	Përgatitja e materialeve teknike dhe diseminimi nëpërmjet faqes së internetit dhe kontakteve direkte	2025–2027	Drejtoria e Teknologjive Bujqësore
2.3	Zhvillimi i aktiviteteve të demonstrimit në ferma për futjen e teknologjive të reja dhe varieteteve bujqësore	Mungesë bashkërendimi me fermerët dhe dobësi në planifikim	Hartimi i kalendarit të demonstrimeve në fillim të çdo viti dhe njoftimi i fermerëve lokalë	Fillimi i çdo viti	Sektori i Kërkimit dhe Baza Eksperimentale

Objektivi 3: Forcimi i etikës dhe transparencës

Nr.	Aktiviteti	Risku	Masa	Afati	Përgjegjësi
3.1	Informimi dhe edukimi i stafit mbi Kodin e Etikës dhe normat e sjelljes institucionale	Shkelje të normave etike dhe morale për shkak të mosinformimit	Organizimi i trajnimeve me pjesëmarrjen e gjithë stafit dhe shpërndarja e udhëzuesve etik	6-mujori i dytë 2025	Drejtuesi i institucionit
3.2	Deklarimi periodik i interesave dhe pasurive për të parandaluar konfliktin e interesit	Rrezik për konflikte interesi dhe mungesë transparence	Zbatimi i ligjit për deklarimet dhe publikimi i rezultateve për transparencë	Çdo vit	Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme & Titullari
3.3	Rritja e aksesit të publikut në informacionin institucional përmes platformave digjitale	Mungesë transparence dhe besueshmërie publike	Publikimi i dokumenteve zyrtare, aktiviteteve dhe raporteve në faqen zyrtare të institucionit	2025	Sekretaria & IT

Objektivi 4: Menaxhimi i infrastrukturës.

Nr.	Aktiviteti	Risku	Masa	Afati	Përgjegjësi
4.1	Investime në agregate bujqësore	Pajisje të amortizuara	Projekt PBA	2025-2027	Titullari
4.2	Planifikimi i ciklit të prodhimit	Rendiment i ulët	Qarkullimi i kulturave	2025-2026	Titullari, Sektori i Prodhimit.
4.3	Pajisje laboratorike	Pajisje të pamjaftueshme	Blerje e re	Janar 2026	Laboratori, Titullari

Grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit

Koordinator: Sotiraq Jankulla Drejtor i Drejtorisë së Teknologjive Blegtorale

Anëtar: Eleni Elefteriu Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve mbështetese

Anëtar: Romeo Prifti Përgjegjës i Sektorit të Mbarështimit

Anëtar: Lazart Suraj Përgjegjës i Sektorit të Punës Racore

Anëtar: Ledion Salillari Përgjegjës i komanduar i Sektorit të Pemëve Frutore e farore

Anëtar: Përparim Kuqo Përgjegjës i Sektorit të Bimëve të Arave dhe Përgjegjës i komanduar i Sektorit të Bazës Eksperimentale Prodhuese